



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **PERPUNIM DRURI**

**Niveli II në KSHK<sup>1</sup>, referuar niveli II të KEK<sup>2</sup>**

**C-II-20**

**Tiranë, 2020**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	PERPUNIM DRURI			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar niveli II të KEK	C-II-20
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli i II Në KSHK, referuar niveli II të KEK, është “zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar, si punëtor ndihmës, në profesione që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin e drurit dhe prodhimin e objekteve prej druri”.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në shkollat që ofrojnë kualifikimin profesional “Përpunim druri” niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;</li> <li>– janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;</li> <li>– kanë aftësi ndryshe, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.</li> <li>– Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë institucionet përgjegjëse përgatitin udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimi për këto shkolla.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli si punonjës gjysmë i kualifikuar/ndihmës në këtë drejtim profesional, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar si ndihmës në firma prodhimi për produkte të gatshme dhe gjysmë të gatshëm prej druri, në qendra tregtare për shitje të materialeve të përpunimit të drurit dhe objekteve prej druri, në punishte të vogla për punime dhe riparime druri.</p> <p>Për sa i përket arsimimit të mëtejshëm, individi ka mundësi të vazhdojë studimet në nivelin III të KSHK, referuar niveli III të KEK, në një prej profileve të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. Me vijimin e mëtejshëm të arsimit profesional në nivelin IV të KSHK, referuar niveli IV të KEK, nxënësi fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	C-II-16			

## **Struktura e kualifikimit**

### **Rezultatet e të nxënit në:**

#### **Njohuri**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Përpunim druri” niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të si më poshtë:

#### **Skicimi dhe vizatimi në punimet e drurit**

- Të lexojë simbolet dhe shenjat dalluese që përdoren në skema të ndryshme të objekteve të thjeshta;
- Të lexojë shkrimin teknik;
- Të përshkruajë shkallët e paraqitjes së trupave në vizatimin teknik;
- Të interpretojë skica dhe vizatime të detaleve dhe objekteve të thjeshta;
- Të interpretojë vizatime dhe skica të lidhjeve të ndryshme ( detaleve të lidhura);
- Të interpretojë vizatime të thjeshta përmbledhëse;
- Të interpretojë vizatimet e pamjeve, prerjeve, në plane të ndryshme, të objekteve të thjeshta prej druri;
- Të interpretojë vizatime të detaleve sipas radhës, me numrin e nevojshëm të pamjeve, gjatë zbërthimit të një objekti të thjeshtë prej druri;
- Të interpretojë paraqitjen e mbishtesave për punim, në vizatimet e detaleve prej druri;
- Të interpretojë vizatime të dymbeve dhe dritareve të thjeshta;
- Të interpretojë vizatime të objekteve të thjeshta të tapicerisë;
- Të interpretojë vizatime të kapriatave të thjeshta prej druri për ndërtim;
- Të interpretojë skica dhe vizatime pjesëve të thjeshta, të objekteve të veçanta prej druri si varka, ski, slita etj.;

#### **Materialet dhe përdorimi i tyre**

- Të përshkruajë llojet e materialeve në depozitat e lëndës së parë dhe produktit të gatshëm në sipërmarrjet e përpunimit të drurit dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri;
- Të përshkruajë llojet e materialeve për sektorin e ngjitjes me lëndë ngjitëse, përdorimet dhe përgatitja e tyre;
- Të përshkruajë përdorimet dhe përgatitjen e materialeve për stukim;
- Të përshkruajë llojet e letrave smeril dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë llojet e materialeve për bojatisjen apo lustrimin e sipërfaqeve të drurit, përgatitjen dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë llojet e materialeve në procesin e tharjes së lëndës së parë;
- Të përshkruajë llojet e materialeve në sektorin e përpunimit të drurit (makineria);
- Të përshkruajë materialet për punime në repartin e montimit;
- Të përshkruajë përgatitjen dhe përdorimet e materialeve për imprenjimin e drurit;
- Të përshkruajë cilësitë dhe përdorimet e materialeve të tapicerisë si susta, sfungjerë, damask etj.;

- Të listojë veçoritë dhe përdorimet e materialeve të tjera për prodhimin e objekteve prej druri si letër zumpare, teni etj.;
- Të listojë aksesoret e ndryshëm që përdoren në procesin e prodhimit të produkteve prej druri dhe përdorimet e tyre;

### **Përgatitja e vendit dhe veglave të punës**

- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e punës për punime në repartin e montimit;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe makinat në sektorin e përpunimit të drurit (makineria);
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matës në procesin e tharjes së lëndës së parë;
- Të përshkruajë mjetet e punës në depozitat e lëndës së parë në sipërmarrjet e përpunimit të drurit dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e punës në sektorin e ngjitjes me lëndë ngjitëse;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e punës për bojatisjen apo lustrim e sipërfaqeve të drurit;
- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve në vendin e punës (sipas rregullave teknologjike e të sigurimit teknik);
- Të përshkruajë mënyrën dhe mjetet e transportit;
- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të materialeve të përpunuara sipas proceseve;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të vendit të punës;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së veglave të punës

### **Trajtimi i lëndës drunore**

- Të përshkruajë llojet dhe rëndësinë e drurëve pyjore;
- Të përshkruajë funksionin e elementeve të strukturës mikro dhe makroskopike të drurit;
- Të përshkruajë vetitë fizike, mekanike dhe kimike në përdorimin e lëndës drunore;
- Të përshkruajë llojet e defekteve të drurit dhe ndikimin e tyre gjatë përdorimit të tij, si dhe mënyrat e mënjanimin të defekteve;
- Të përshkruajë lagështirën e drurit, si dhe mënyrat e përcaktimit të saj;
- Të përshkruajë mënyrat e tharjes së drurit;
- Të përshkruajë llojet e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri dhe rëndësinë e secilit në objektet prej druri;
- Të përshkruajë karakteristikat e lëndës së parë, për prodhimin e lëndës së sharruar;
- Të përshkruajë vetitë dhe përdorimet e rimesos dekorative, kompensatës dhe drurit me shtresa;
- Të dallojë asortimentet e lëndës së parë dhe ndihmëse për pllakë zdrukthi dhe fibre;
- Të klasifikojë pllakën e zdrukthit dhe të fibrës sipas vetive fiziko – mekanike;
- Të përshkruajë mënyrën e përcaktimit të vetive fiziko – mekanike gjysmë të gatshme prej druri;
- Të përshkruajë hapat e teknologjisë së prodhimit gjysmë të gatshme prej druri;

- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes dhe trajtimit të trupave dhe lëndës drusore, mënyrat e duhura;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së trupave për imprenjim me lëndë kimike;
- Të përshkruajë rregullat e ndarjes dhe stivimit të lëndës së sharruar për tharje;
- Të përshkruajë llojet e punimeve të thjeshta në tharëset e lëndës drunore;
- Të përshkruajë mënyrat e sistemimit të lëndës drunore të tharë;

### **Punime të drurit në makineri**

- Të listojë veglat, pajisjet e mekanizuara dhe makinat në punimet e drurit;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të veglave të dorës në punimet e drurit;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të pajisjeve të mekanizuara në punimet e drurit;
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të makinave bazë të përpunimit të drurit si: makina sharrë shirit, sharrë rrethore, plani drejtues, grosecë, trapani, freza me bosht vertikal nga poshtë, dhe makina e zumparimit;
- Të dallojë detalet e lidhjet midis tyre në funksionimin e makinës;
- Të përshkruajë llojet e lidhjeve mekanike, me vidë, dado – bullon, kiavetë, perçinë, saldim etj.;
- Të përshkruajë llojet e transmisioneve me rrip, me ingranazhe, me yllëza, me fërkim dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit mekanik, hidraulik, pneumatik në presa;
- Të përshkruajë bazat e përpunimit mekanik të drurit dhe faktorët që ndikojnë në të;
- Të përshkruajë proceset e punës, në materialin drunor me veglat e dorës;
- Të përshkruajë proceset e punës, me mjetet e mekanizuara, të përpunimit të drurit;
- Të përshkruajë përgatitjen për punë dhe përdorimet e mjeteve të mekanizuara;
- Të dallojë llojet dhe përdorimet e makinave të sharrimit me avancë dhe me dorë;
- Të listojë veçoritë e punimit në makinën plan drejtues dhe grosetë;
- Të rendisë llojet e instrumenteve prerës në veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit;
- Të përshkruajë përgatitjen për punë, si dhe llojet e punimeve që kryhen në makinat e shpimit të drurit;
- Të dallojë llojet dhe veçoritë e përdorimit të makinave të zumparimit;
- Të përshkruajë makineritë e profilimit të drurit dhe funksioni i tyre;
- Të përshkruajë makinat e copëtimit të drurit dhe funksioni i tyre;
- Të përshkruajë makinat e smerilimit, kalibrimit dhe funksioni i tyre;
- Të përshkruajë makinat e formimit të qilimit të pllakave dhe përdorimi i tyre
- Të përshkruajë makinat e presimit dhe funksioni i tyre;
- Të përshkruajë llojet e veglave të dorës të thjeshta dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë llojet e proceseve teknologjike ( punës ) që kryen sipas makinerisë përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e operacioneve të mirëmbajtjes të instrumenteve prerës;
- Të përshkruajë procesin e mprehjes së instrumenteve, ngjitjes së shiritit etj.;

### **Punime ndihmëse në lyerje, lustrim dhe ngjitje,**

- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detaleve dhe pllakave të punuara para lyerjes;

- Të dallojë llojet e makinerive dhe pajisjet që përdoren për stukim, lyerje dhe lustrim;
- Të përshkruajë smerilimin e detaleve, pllakave, veçoritë e tij;
- Të shpjegojë mënyrën e pastrimit të sipërfaqeve mbas zumparimit dhe rëndësinë e tij;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së bojës dhe llakut sipas recetave;
- Të dallojë pajisjet e thjeshta për aplikimin e bojës dhe llakut në sipërfaqen e materialit drunor;
- Të përshkruajë mënyrat e lyerjes;
- Të shpjegojë rregullat e stivimit të materialit të lyer për tharje natyrore dhe të detyruar;

### **Punime ndihmëse në montim**

- Të tregojë mënyrën e ndarjes dhe sistemimit të materialit sipas skicës;
- Të listojë veglat, pajisjet për montim dhe funksionin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të pajisjeve ndihmëse në montimin e objekteve prej druri;
- Të përshkruajë mënyrën e matjes dhe shënimit mbi materialin drunor;
- Të dallojë radhën e punës në montim;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të skicave dhe vizatimit teknik gjatë montimit;
- Të listojë hapat e përgatitjes së detaleve, elementeve dhe pllakave për montim;
- Të përshkruajë hapat e montimit të komplekseve për objektin, sipas skicës;
- Të përshkruajë hapat e montimit të nën-ansambleve, sipas skicës;
- Të listojë hapat e ndërtimit të ansambleve për objektin sipas skicës;
- Të përshkruajë hapat e përgatitjes së detaleve dhe pjesëve të përkulura me mjete të thjeshta;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së lëndës së parë dhe materiale të tjera për objekte të thjeshta prej druri;
- Të përshkruajë radhën e punimeve të tapicerisë në objekte të thjeshta;
- Të dallojë aksesorët, llojet e tyre dhe përdorimet;
- Të përshkruajë mënyrën e ambalazhimit dhe transportimit të objekteve në destinacion;
- Të përshkruajë llojet e riparimeve të thjeshta gjatë procesit të përpunimit të drurit;

### **Kontrolli i punimeve**

- Të përshkruajë mënyrat e thjeshta të verifikimit të cilësisë së punimeve në depozita të lëndës së parë sipas standardeve;
- Të përshkruajë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve gjatë tharjes së drurit në pajisjet përkatëse sipas kushteve teknike;
- Të përshkruajë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e makinerisë sipas skicës;
- Të përshkruajë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e montimit sipas skicës;
- Të përshkruajë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë në vendosjen e aksesorëve metalikë, të nevojshëm në objekt, sipas skicës;
- Të dallojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e ngjitjes;
- Të dallojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e lyerjes

dhe lustrimit sipas kërkesës.

### **Rregullat e sigurisë mbrojtjes së dhe mjedisit**

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe shëndetësor sipas vendit të punës;
- Të listojë pajisjet e mbrojtjes dhe sigurisë personale në punë duke përshkruar përdorimet e tyre;
- Të interpretojë manualeve të pajisjeve dhe makinerive;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes ndaj rrymës elektrike, mbrojtjen nga efektet termike etj.;
- Të interpretojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
- Të përkufizojë rregulloren e brendshme e biznesit;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri (MSHNZ);

### **Komunikimi**

- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës në komunikim me eprorët, kolegët dhe të tjerë;
- Të përshkruajë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknikave të motivimit për arritjen e komunikimit të mirë me të tjerët.

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Përpunim druri” niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale si më poshtë:

### **Skicimi dhe vizatimi në punimet e drurit**

- Të përzgjedhë dhe përdorë materialet, veglat, pajisjet për vizatim dhe skicim;
- Të vizatojë ose skicojë simbolet dhe shenjat dalluese që përdoren në vizatimet teknike;
- Të përdorë shkrimin teknik;
- Të zgjedhë pozicionin e përshtatshëm të modelit që do vizatohet ose skicohet;
- Të bëjë vizatime dhe skicime të pamjeve dhe prerjeve të objekteve të thjeshta;
- Të zbatojë shkallët në skicë dhe vizatimet;
- Të zbatojë rregullat e vendosjes së përmasave në skica dhe vizatime të thjeshta;
- Të realizojë paraqitjen e objekteve të thjeshta në aksonometri;
- Të realizojë skema të thjeshta të objekteve prej druri;

- Të realizojë skica dhe vizatime të pamjeve, prerjeve në plane të ndryshme të objekteve të thjeshta prej druri;
- Të bëjë skica dhe vizatime të lidhjeve të thjeshta të detaleve prej druri;
- Të realizojë vizatime të detaleve sipas radhës, me numrin e nevojshëm të pamjeve, gjatë zbërthimit të një objekti të thjeshtë prej druri;
- Të paraqesë mbishtesat për punim, në vizatimet e detaleve prej druri;
- Të bëjë skica dhe vizatime të dyerve dhe dritareve të thjeshta;
- Të realizojë skica dhe vizatime objekteve të thjeshta të tapicerisë;
- Të realizojë skica dhe vizatime modele dhe kapriata të thjeshta prej druri për ndërtim.
- Të realizojë skica dhe vizatime pjesëve të thjeshta të objekteve të veçanta prej druri si varka, ski, slita etj.;

### **Materialet dhe përdorimi i tyre**

- Të ndihmojë në përzgjedhjen e materialeve në repartin e montimit;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve në sektorin e ngjitjes;
- Të përzgjedhë materialet e duhura për stukimin e sipërfaqeve të drurit;
- Të ndihmojë në përgatitjen e materialeve të thjeshta për bojatisjen apo lustrim e sipërfaqeve të drurit;
- Të seleksionojë llojet e materialeve në depozitat e lëndës së parë dhe produktit të gatshëm në sipërmarrjet e përpunimit të drurit dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri;
- Të ndihmojë në përgatitjen e materialeve për procesin e tharjes së lëndës së parë;
- Të përzgjedhë materialet në sektorin e përpunimit të drurit (makineria);
- Të ndihmojë në përgatitjen e materialeve për imprenjimin e drurit;
- Të ndihmojë në përzgjedhjen e materialeve të tapicerisë si susta, sfungjerë, damask etj.;
- Të ndihmojë në përzgjedhjen e materialeve të tjera për prodhimin e objekteve prej druri si letër zumpare, teni etj.;
- Të ndihmojë në përzgjedhjen e aksesoreve të ndryshëm që përdoren në procesin e prodhimit të produkteve prej druri;
- Të përzgjedhë materialet e duhura për ambalazhimin e produkteve prej druri;

### **Përgatitja e vendit dhe veglave të punës**

- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta të punës për punime në repartin e montimit;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta të punës në sektorin e ngjitjes;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta të punës për bojatisjen apo lustrim e sipërfaqeve të drurit;
- Të përdorë mjetet e thjeshta të punës në depozitat e lëndës së parë në sipërmarrjet e përpunimit të drurit dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri;
- Të përdorë mjetet e thjeshta të punës dhe instrumentet matës në procesin e tharjes së lëndës së parë;
- Të sistemojë materialet, mjetet e punës dhe instrumentet matëse e niveluese në vendin e duhur punës;
- Të zgjedhë materialin sipas procesit të punës që do kryhet;



- Të furnizojë vendin e punës me materialin e zgjedhur duke përdorur mjetet e duhura të transportit;
- Të sistemojë, stivojë materialin sipas rregullave të caktuara;
- Të pastrojë mjetet duke zbatuar rregullat e duhura teknike;
- Të përdorë pajisjet e mbrojtjes dhe sigurisë personale në punë;
- Të kryejë mirëmbajtjen e veglave të punës;
- Të kryejë pastrimin e vendit të punës sipas udhëzimeve;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale në punë;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;

### **Trajtimi i lëndës drunore**

- Të përzgjedhë llojet e drurëve pyjore nën mbikëqyrje;
- Të përzgjedhë materialin drunor sipas vetive të tij, fizike, kimike, mekanike etj. në mbikëqyrje;
- Të ndihmojë në ndarjen e materialit drunor sipas defekteve dhe mënjanimin e tyre;
- Të përcaktojë lagështirën e drurit me mënyra të thjeshta nën mbikëqyrje;
- Të ndihmojë në përzgjedhjen e mënyrës së tharjes së drurit, sipas llojit dhe përdorimit;
- Të ndihmojë në përzgjedhjen e llojit të prodhimit gjysmë të gatshme prej druri gjatë përdorimit në objektin përkatës;
- Të ndihmojë në ndarjen e trupave drunorë, sipas karakteristikave për prodhimin e lëndës së sharruar;
- Të përcaktojë defektet e thjeshta të drurit;
- Të ndihmojë në përcaktimin e vetive të rimesos dekorative, kompensatës dhe drurit me shtresa;
- Të ndihmojë në seleksionimin e asortimenteve të lëndës së parë dhe ndihmëse për pllakë zdrukthi dhe fibre;
- Të ndihmojë në përzgjedhjen e pllakës së zdrukthit dhe të fibrës sipas vetive fiziko – mekanike;
- Të përcaktojë veti të thjeshta fizike dhe mekanike të materialit drusor;
- Të ndjekë hapat e teknologjisë së prodhimit gjysmë të gatshme prej druri;
- Të ndihmojë në sistemimin e trupave dhe lëndës drusore për ruajtje dhe trajtim me mënyrat e duhura;
- Të ndihmojë në përgatitjen e trupave për imprenjim me lëndë kimike;
- Të ndihmojë në stivimin e lëndës së sharruar për tharje, sipas rregullave të caktuara;
- Të ndihmojë në punime të thjeshta në tharëset e lëndës drunore;
- Të sistemojë lëndën drunore të tharë sipas rregullave;
- Të mirëmbajë pajisjet dhe ambientin në tharëse;

### **Punime ndihmëse në makineri**

- Të ndihmojë gjatë punimit në makinat bazë për manovrimin e detalit, pllakës etj. duke zbatuar instruksionet e personit përgjegjës;
- Të kryejë matje dhe shënime të thjeshta në elementet prej druri;
- Të kryejë procese të thjeshta në makinat bazë nën mbikëqyrje duke zbatuar

instruksionet e personit përgjegjës;

- Të ndihmojë gjatë kryerjes së proceseve të punës në makinat e profilimit të drurit duke zbatuar instruksionet e personit përgjegjës;
- Të ndihmojë gjatë proceseve të punës në makinat e smerilimit, kalibrimit duke zbatuar instruksionet e personit përgjegjës;
- Të ndihmojë gjatë proceseve të punës në makinat e copëtimit duke zbatuar instruksionet e personit përgjegjës;
- Të ndihmojë në makinat e formimit të qilimit të pllakave me bazë druri duke zbatuar instruksionet e personit përgjegjës;
- Të ndihmojë në procese të thjeshta në makinat e presimit duke zbatuar instruksionet e personit përgjegjës;
- Të ndihmojë në procese të thjeshta në makinat e formatizimi duke zbatuar instruksionet e personit përgjegjës;
- Të ndihmojë në proceset teknologjike të punës sipas makinerisë përkatës.

#### **Punime ndihmëse në lyerje e lustrim**

- Të ndajë detalet dhe pllakat e punuara nën mbikëqyrjen e specialistit ;
- Të smerilojë detalet dhe pllakat sipas shkallës së pastërtisë së përcaktuar në skicë, nën mbikëqyrjen e teknikut;
- Të pastrojë detalet dhe pllakat sipas shkallës së pastërtisë në skicë;
- Të përgatitë bojën dhe llakun sipas recetave, nën mbikëqyrjen e teknikut;
- Të kryejë stukime të thjeshta;
- Të lyejë sipërfaqe druri me bojë apo llak duke përdorur furçë, pistoletë etj.;
- Të stivojë materialin e lyer për tharje natyrore dhe të detyruar, sipas rregullave të caktuara, nën mbikëqyrjen e teknikut;
- Të dallojë shkallën e pastërtisë të detaleve sipas kërkesave;
- Të realizojë tharjen e sipërfaqeve të lyera me bojë dhe llak;

#### **Punime ndihmëse në montim**

- Të transportojë detalet, pllakat elementët e punuara, në makineri te vendi i montimit sipas kërkesës;
- Të lexojë skicën (vizatimin);
- Të ndajë elementët e punuara sipas vendit dhe radhës së punës;
- Të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për montim nën mbikëqyrje;
- Të përdorë instrumentet matës në montimin e objekteve prej druri;
- Të përzgjedhë aksesorë të ndryshëm sipas skicës nën mbikëqyrje;
- Të realizojë punime të thjeshta në veshjen e brinjëve të pllakave të ndryshme, sipas skicës;
- Të realizojë montimin e komplekseve të thjesht për objektin sipas skicës;
- Të realizojë montimin e nën-asambleve të thjeshta sipas skicës;
- Të realizojë montimin ansambleve të thjeshta për objektin sipas skicës;
- Të realizojë vendosjen e aksesorëve metalikë në objektet të thjeshta prej druri;
- Të kryejë punime me mjete të thjeshta për përkuljen e detaleve prej druri;

- Të realizojë veshjen me tapiceri të objekteve të thjeshta;
- Të montojë objektin në repart apo destinacion, sipas radhës së punës në skicë, në bashkëpunim me të tjerë;
- Të ambalazhojë objektet sipas standardit;
- Të pastrojë dhe sistemojë, sipas rregullave, vendin e punës;
- Të kryejë riparime të thjeshta gjatë procesit të përpunimit të drurit;

### **Kontrolli i punimeve**

- Të kryejë verifikime të thjeshta të cilësisë së punimeve në depozita të lëndës së parë sipas standardeve;
- Të kryejë kontrollit të thjeshta të cilësisë së punimeve gjatë tharjes së drurit në pajisjet përkatëse sipas kushteve teknike;
- Të kryejë verifikime të thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e montimit sipas skicës;
- Të kryejë kontrollit të thjeshta të cilësisë në vendosjen e aksesorëve metalikë, të nevojshëm në objekt, sipas skicës;
- Të dallojë defektet e mundshme të punimeve në sektorin e ngjitjes;
- Të dallojë defektet e mundshme të punimeve në sektorin e lyerjes dhe lustrimit sipas kërkesës.

### **Rregullat e sigurisë, mbrojtjes dhe mjedisit**

- Të zbatojë manualët përkatëse në përdorimin e pajisjet dhe makineritë;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Të respektojë e sinjalistikën në terren;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të respektojë masat e mbrojtës gjatë punimeve në lartësi;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes personale në punë;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së distancave të rekomanduara në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat për mbrojtjen ndaj rrymave ose tensionit;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;

### **Komunikimi**

- Të përdorë terminologji të qartë dhe profesionale në komunikim;
- Të zbatojë rregullat e hierarkisë profesionale
- Të zbatojë teknikat e motivimit për të arritur një komunikim të mirë me të tjerët
- Të raportojë tek mbikëqyrësi për detyrën e kryera, duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale
- Të zbatojë format dhe mënyrat e duhura të raportimit;
- Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët;
- Të zbatojë kodin e etikës në komunikim me eprorët, kolegët dhe të tjerë;

## **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.